



PRISHTINA

RAPORTI I PUNËS I KOMUNËS SË PRISHTINËS

(7 Dhjetor 2021 - 31 Mars 2022)

KY RAPORT PASOYRON PUNËN E KOMUNËS SË PRISHTINËS

Prishtinë, 2022

Qytetarë të Kryeqytetit,

Kaluan tashmë më shumë se njëqind ditë që kur me ekipin tim morrëm përgjegjësinë për drejtimin e Kryeqytetit, me qëllim që ta jetësojmë vizionin tonë për transformimin e Prishtinës në përputhje me planin, projektet dhe konceptet që shpalosëm vjet gjatë fushatës parazgjedhore. Sot, mund të shpallim se shumë nga projektet e premtuara gjatë fushatës, i kemi vënë në binarët e duhur.

Siç do ta shihni në Raportin e parë të punës, projekte nga të gjitha llojet e sektorëve: urbane, infrastrukturore, brendapërbrenda dhe rretheqark; shëndetësore, në këto kohë sfiduese; restauruese, në linjë me vizionin tonë për Prishtinën e përjetimeve; mjedisore, për hapësira të reja të gjelbëruara; bujqësore, për ujitjen e tokave të mbjella; zhvillim rural, rekreative, për më shumë ndërveprim sportiv.

Këto të mësipërmet janë veç disa nga nismat e deritashme dhe të gjitha vetëm nga "ana e dukshme e medaljes".

Gjatë këtyre muajve punuam ngjeshur edhe që i gjithë kabineti të zotërojë njohje të mirëfilltë të legjislacionit në fuqi (primar e sekondar) në fushën e vetëqeverisjes lokale. Prishtina, ndryshe nga çdo komunë tjetër, me Ligjin për Kryeqytetin gëzon status të veçantë, që përkthehet në kompetenca, por edhe në përgjegjësi të shtuara. Ky realitet përkon me ambicien tonë. Ne duam ta shtrijmë, deri në nivele kapilare, brenda dhe jashtë organit tonë vetëqeverisës, mendësinë e re – atë të Institucionit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës.

Partneritetet e panumërta, që gjatë këtyre ditëve i zyrtarizuar me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, me ambasadorë të huaj, me ministra e titullarë të tjerë të pushtetit qëndror, si dhe akterë të tjerë ndërkombëtarë e vendorë, po i konkretizojmë, gjithmonë duke i gjetur pikëtakimet me palën ndërvepruese, pikërisht drejt vizionit tonë transformues për Kryeqytetin e Prishtinës.

Jo më pak të rëndësishme janë takimet, po aq të shumta gjatë kësaj kohe, me drejtues organizatash të ndryshme joqeveritare, pjesëtarë të komunitetit të biznesit, të artistëve, të asociacioneve sportive, fetare, e deri te ato me qytetarë. Asnjë qeverisje gjithëpërfshirëse nuk mund të mendohet pa kontakte të ngushta e pa mirëbesimin e njerëzve që artikulojnë nevoja e propozime prej grupeve të ndryshme interesi, ndërkohë që veprojnë edhe si kundërpesha që ndihmon për ta mirëmbajtur baraspeshimin. Gjithçka, në fund, bëhet për interesin e përbashkët qytetar.

Ky është vetëm fillimi. E rëndësishmja është se jemi vënë, tashmë me hapa gjithnjë më të sigurt e më të shpejtë, në rrugë të mbarë.

Sinqerisht,


Përparim Rama

Kryetar i Kryeqytetit

TRANSFORMIMI I PRISHTINËS


Gjatë kësaj periudhe kemi arritur që të merremi me projekte të rëndësishme kapitale, si:

Unaza e Mesme




Projekti për ndërtimin e unazës së mesme të qytetit, ku në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe me Ministrinë e Infrastrukturës është dakorduar për vijën (trazenë) e "Unazës së Mesme" së Prishtinës. Në muajt e ardhshëm do të bëhet projekti konkret i "Unazës së Mesme".

MUZEU I ARTIT MODERN "Te Tulltorja"



Është kompletuar dokumentacioni që do të shërbejë për shpalljen e konkursit ndërkombëtarë për projektin.


RR. MUHARREM FEJZA



Tashmë është arritur marrëveshja me disa pronarë në rrugën "Muharrem Fejza", në mënyrë që të lirohet një segment kyç i rrugës dhe të vazhdohet me ndërtimin e rrugës.


Njëkohësisht është arritur që të lirohet rruga nga disa pengesa (baraka), të cilat nuk lejonin vazhdimin e punimeve në rrugën "Muharrem Fejza". Është filluar puna me planin dinamik 40-ditor të punës në këtë rrugë, ku do të trajtohet ndriçimi publik, kubëzat në trotuar, bordurat e dëmtuara dhe do të pastrohet i gjithë rrjeti i kanalizimit fekal dhe atmosferik.

Platforma lidhëse e Pallatit të Rinisë me lagjen Arbëria




Është kompletuar dokumentacioni që do të shërbejë për shpalljen e konkursit ndërkombëtarë për projektin.

RRUGA A




Projekti zbatues i rrugës është afër përfundimit. Gjatë muajit prill pritet të tenderohet pjesa e parë e rrugës, me një gjatësi rreth 2 km, që e trajton "Zonën e Kalabrisë" dhe "Prishtinës së Re". Ky projekt do të trajtojë edhe kolektorin e "Kalabrisë", ku do të zgjidh një shqetësim të madh të banorëve të asaj zone, përkatësisht problemin e kundërmimit.

SOLAR4KOSOVO



Krijimi i kushteve për fillimin e realizimit të projektit "Solar4Kosovo", i cili do të mundësoj kyçjen në rrjetin e ngrohjes qendrore për 12 mijë familje, apo 60 mijë banorë të Komunës së Prishtinës.

QENDRA E TRAJTIMIT TE QENVE ENDACAK



Është bërë një punë e jashtëzakonshme për trajtimin e qenve endacak, me ç'rast janë ndërmarrë veprimet si në vijim:

- *Jane duke u zhvilluar procedurat finale për ndërtimin e Qendrës së përkohshme për trajtimin e qenve endacakë në Hajvali.*
- *Ndarja e 10 hektarëve për ngritjen e "Strehimorës për kafshë" në Slivovë*
- *Është hartuar strategjia 10 pikëshe për qentë endacak*
- *Kemi organizuar konferencën rajonale për bashkëpunim ndër-komunal, me qëllim të zgjidhjes afatgjate të problemit të qenve endacak;*
- *Koordinim i vazhdueshëm me AUVK për fillimin e regjistrimit të qenve endacakë;*
- *Është nënshkruar marrëveshja me operatorët e jashtëm për sistemin KSVL (kapje, sterilizim, vaksinim dhe lëshim)*
- *Është bërë ngritja e pikave ushqyese për qentë endacak nga 5 në 23 sosh.*

PROJEKTET ME GIZ DHE KfW

Bashkërendim i veprimeve me GIZ dhe KfW rreth projekteve kapitale, duke përfshirë atë të **paneleve solare, të mbledhjes së mbeturinave dhe trajtimi i ujërave të zeza.**

EBRD - TRAFIKU URBAN

Thellim i bashkëpunimit me EBRD dhe Trafikun Urban lidhur me **blerjen e autobusëve** të rinj, si dhe rregullimin e linjave në Komunën e Prishtinës.

MILLENNIUM CHALLENGE CORPORATION

Thellim i bashkëpunimit me MCC për vazhdimin e projekteve, me theks të veçantë, atë për **matësit e ngrohjes qendrore** me NP Termokos si dhe të projektit të Efijencës Energjetike - te "**Soliterat e Ulpianës**".

PËRDITËSIMI I LISTËS SË PRONAVE KOMUNALE

Hartimi dhe publikimi i listës së përgjithshme të pronës komunale (Komuna e Prishtinës nuk ka përditësuar listën e pronës komunale nga viti 2015 ndërsa, pavarësisht se nga viti 2019, kjo gjë është kërkuar me Ligj, publikimi nuk është bërë asnjëherë).

LIRIMI NGA PAGESAT

Lirohen nga pagesat e përdorimit të trafikut urban Policia e Kosovës, FSK, Zjarrëfikësit dhe nxënësit e shkollave fillore të Komunës së Prishtinës. Ky vendim u marr në shenjë falënderimi për punonjësit e linjës së parë dhe për të stimuluar përdorimin e transportit publik tek gjeneratat e reja.

LIRIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE

Janë liruar hapësirat publike të cilat ishin uzurpuar tash e tetë vite më parë: hapësirat me lodra (jofunksionale), disa objekte me karakter të përkohshëm si dhe largimin e disa kontejnerëve dhe mbeturinave të shumta e të grumbulluara në dy hapësira publike:
1. Hyrja qendrore e parkut të "Tauk Bashqes"
2. Hapësira afër hyrjes së QKUK-së.

PLANI RREGULLUES

Anulimi i vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria", nr. 01-350/05-245432/21, i dt. 12.11.2021;
Anulimi i vendimit për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërisht të bllokut urban "D 2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", i miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01.nr.35-94056, dt. 04.05.2015;

HARTIMI I LISTËS SË VEÇANTË

Për pronat komunale të cilat planifikohet të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2022, ku ndër të tjera përfshihen pronat në të cilat do të zhvillohen projekte të mëdha të premtuara siç janë: **Strehimorja për kafshët, Parku për festivale, Thertorja e qytetit, fusha të futbollit si dhe Kuarti për Ambasada.**


KOMPLETIMI I DOSJEVE PËR PROJEKTE

Është bërë mbledhja e informacioneve dhe përpunimi i të dhënave për të kompletuar dosjet për projektet:

- "Parku në Kampusin e Universitetit",
- "Stacioni i Autobusëve",
- Njëra pjesë e lagjes "Kalabria",
- "Zona e Vjetër e Qytetit",
- "Tregu",
- "Soliterat" në lagjen "Ulpiana".

VENDIMI PËR ÇMIMOREN E AUTO-TAXI

Është miratuar ndryshimi dhe plotësimi i i vendimit 01. Nr.344-40495, e datës 27.03.2013, për caktimin e çmimores për transportin publik të udhëtareve me auto-taxi, në Komunën e Prishtinës



120 ditë, mikëpritje, punë dhe kujdes.



01 **350+** **Takime** me qytetarë në secilën pjesë të Prishtinës.

03 **17** **Ambasadorë** i mirëpritëm

05 **6** **Pjesëmarrje** në konferenca

07 **10** **Projekte** të mëdha me donatorë serioz

09 **17** **Vizita/takime** komunitetit të sportit dhe kulturës

11 **12** **Intervista** në media të shkruara/elektronike dhe konferenca për shtyp

13 **11** **Memorandume** të bashkëpunimit (6 të përfunduara dhe 5 në proces)

02 **36** **Bashkëpunime** me Organizata joqeveritare, vendore dhe ndërkombëtare

04 **12** **Agjenci** dhe donatorë i takuam

Thelluam bashkëpunimin me Qeverinë:

06 **15** **Takime** pune me Ministra

08 **15** **Vizita** në terren tek ofruesit e shërbimeve për qytetarët (Institucione Komunale dhe NP)

10 **40** **Pjesëmarrje** në aktivitete të ndryshme përfshirë edhe ato ceremoniale

12 **15+** **Orë diskutim** në Kuvendin e Komunes për dy seanca të rregullta – standard i ri

11 Memorandume të bashkëpunimit (6 të përfunduara dhe 5 në proces)

MoU - Ministria e Mbrojtjes, ofrimi mbështetjes nga përmes njësive të FSK-së në realizimin e aktiviteteve për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së qytetarëve që mund të cenohen dhe rrezikohen nga prania e asbestit në zonen urbane, sidomos pranë shkollave dhe në lagjet e urbanizuara të Prishtinës.

MoU - UN-HABITAT, bashkëpunim për projektet e zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor, promovimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin e hapësirave të gjelbra publike, veprimin klimatik dhe strehimin, duke i pasur komunat e tjera dhe komunitetet të integruara në çdo hap të planifikimit dhe të zbatimit, brenda kornizave të bashkëpunimit efektiv ndër-komunal dhe qeverisjes në disa nivele.

MoU - CHEMONICS INTERNATIONAL, partner i USAID për zbatim efektiv të programit për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe thjeshtësimin e procesit të leshimit të lejeve ndërtimore në komunën e Prishtinës

MoU - Me Shefin e EULEX, marrëveshje për donacion (nga kjo marrëveshje, Drejtoria e Mireqenies Sociale e Prishtinës dhe dy shkolla fillore (Shkëndija dhe Shkolla Speciale - Qendra Burimore-Perparimi) kanë pranuar pajisje të teknologjisë informative dhe automjeteve

MoU - AMBASADA NORVEGJEZE, përkrahë Komunën në fushat e politikbërjes, planifikimit, zhvillimit dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera publike e ndërveprojne me komunën tonë.

MoU - ShSKUK, ofrohet shërbim efikas për pacientët e shtrirë në Klinikën e Nefrologjisë në QKUK e në raste kur mungojnë hapësirat për trajtim, pacientët do të vazhdojnë të trajtohen edhe me tutje në QMF-në e lagjes Kodra Trimave

MoU - Sustainability Leadership Kosova, Ky memorandum ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e të dy subjekteve në punën drejt mundësive që mund të forcojnë agjendat e qëndrueshmërisë në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën dhe në rajonin e saj, në fushën e ruajtjes së ambientit dhe promovimit të kujdesit ndaj tij.

MoU - Agjencia Katastrale te Kosoves, kompletimin e sistemit të adresave në territorin e komunës

MoU - Policia e Kosoves - për fushën e sigurisë në qytet

MoU - Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina Fakulteti I Bujqësisë dhe Veterinarisë - u dakorduan për nevojën e përcaktimit të modaliteteve të bashkëpunimit në mes tyre në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë përmes ofrimit të ekspertizës së nevojshme për ngritjen e cilësisë dhe kapaciteteve humane.

MoU - Fondacioni për të drejtat e kafshëve - Qëllimi kësaj marrëveshje bashkëpunimi përfshin, por nuk kufizohet në, monitorimin e projekteve që janë në zhvillim e sipër apo projekteve që mund të fillojnë në të ardhmen, të cilat zhvillohen apo udhëhiqen nga KOMUNA, që kanë të bëjnë me mirëqenien e kafshëve shoqëruese dhe endacake në territorin e Komunës



PRISHTINA

RAPORTET E PUNËS SË DREJTORIVE

Drejtoria e urbanizmit



Aktivitete të vazhdueshme me Ministrinë e Planifikimit dhe Infrastrukturas me qëllim të bashkërendimit të punëve në realizimin e Unazës së Mesme të Prishtinës, projektit të Parkut Energjetik Solar i mbështetur nga KFW, që rezultuan në krijimin e kushteve për realizimin e projekteve.

- Punë të vazhdueshme me BERZH për trasenë të Unazës së Mesme. Nga analizat e bëra rezultoi se varianti më ekonomik është 4-MT1 dhe 4-MT2. Në vazhdimësi është duke u punuar me hartuesin e projektit SWECO dhe InfraPlus me qëllim të definimit të disa pjesëve të trasesë të cilat janë akoma të padefinuara.
- Komuna e Prishtinës, Ministria e Planifikimit dhe Infrastrukturas dhe Kryetari të Komunës së Obiliqit, së bashku me akterët relevant, me qëllim të bashkërendimit të punëve në realizimin e projektit të Parkut Energjetik Solar janë dakorduar për krijimin e kushteve për realizimin e projektit. Komuna e Prishtinës u zotua për kompenzimin e marrjes në shfrytëzim të tokës nga ana e komunës së Obiliqit në pjesën ku vendosen panelet solare.

Identifikimi i rrezeve dhe mundësive të secilit lokacion të paraparë për ndërtesat të cilat do të jenë pjesë e konkurseve arkitektonike ndërkombëtare – për planifikimin e aktiviteteve

rreth nisjes së projekteve të mëdha kapitale pjesë e vizionit të kryetarit Rama për zhvillimin e Kryeqytetit.

Aktivitete të vazhdueshme me Millenium Foundation Kosovo, lidhur me projektin e efikasitetit energjetik tek Soliterat e Ulpianës. Dakordim që të shkohet përpara në realizimin e projektit. MMF merr përsipër ndryshimin e paramasës dhe detajeve teknike të detajeve të fasadës me qëllim të ruajtjes së identitetit të ndërtesës, para se të shkojë në fazën e prokurimit.

Salla Koncertale tek Gërmia – Komuna e Prishtinës ka bërë analizën hidrologjike të prurjeve të lumit i cili kalon poshtë themeleve të ndërtesës ekzistuese të Gërmisë. Rezultatet e këtij studimi kanë mundur kushte teknike për vendosjen e ndërtesës së re.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Parqeve është punuar në riorganizimin e mënyrës së mirëmbajtjes së hapësirave gjelbëruese ekzistuese dhe identifikimi i hapësirave të reja për intervenim në Kryeqytet.


Së bashku me Drejtorinë e Arsimit është bërë përcaktimi i lokacionit për ndërtimin e çerdhes (Lagja Kolovicë) përfshirë përgatitjen dhe dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm tek Ministria e Arsimit.

Themelimi i studios Kreative e cila merret me hartimin e projekteve kreative për intervenime të vogla në qytet. Veprime të nevojshme në intervenime mikroubane për përgatitjen nevojshme për prokurim. Përgatitja e dosjeve për konkurse arkitektonike.

Identifikimi i mundësive të digjitalizimit të procesit të aplikimit dhe trajtimit të lejeve ndërtimore.

Së bashku me MKRS kemi punuar për përcaktimin e lokacionit “Teatri i Operas dhe Baletit”, ku jemi dakorduar tek parkingu i Qendrës Rinore dhe tutje të vazhdohet me procedurat e nevojshme për hapjen e konkursit.

Drejtoria e Investimeve Kapitale



Identifikimi dhe fillimi i trajtimit të gropave në rrugët e qytetit dhe në zonat rurale

Inicimi i hartimit të projekteve kryesore për rrugët si më poshtë:

- Përfundimi i projektit në Shkabaj dhe përgatitja e materialit për tendrim;
- Përfundimi i projektit në Bardhosh dhe përgatitja e materialit për tenderim : Rr, "Gonxhe Bojaxhiu" dhe "Skenderbeu"
- Projektimi i rikonstruimit të rrugëve " Hilmi Rakovica", "Dervish Rozhaja" dhe "THimi Mitko";
- Projektimi i rikonstruimit të rrugëve "Xheladin Rekalii" dhe Rr. "Enver Maloku" (segmenti nga kryqëzimi me Rr.,,Xheladin Rekalii" deri në me Rr."B").
- Projektimi i rikonstruimit të Rr. "Rexhep Krasniqi dhe Rr. "Kasim Shala"- Kalabri;
- Projektimi i rikonstruimit të Rr. "SHefqet Shkupi" (Tahir Deva), "Agim Qela" dhe Rr.

"Harum Aliu".

- Projektimi i rrugës lidhëse me Rr. "Sadik Beka"-Mati;
- Projektimi i rrjetit të rrugicave në fshatin Sharban;
- Projektimi i vazhdimit të kanalizimit fekal në fshatrat Makovc, Grashticë dhe Mramor;

Përgatitja e materialeve dhe ofertimi sipas planifikimit për vitin 2022 si në vijim:

- "Ndërtimi i rrugës nga lagja Vrapaca deri te lagja Latifi";
- "Ndërtimi i rrugës Ibrahim Beka";
- "Ndërtimi i rrugës Rimanishtë -Siqevë;
- "Ndërtimi i rrugës Rrahim dhe Shabi Gerbeshi - Lagja Gerbesh -Marevc";
- "Ndërtimi i rrugës Kaçakët në Prapashticë - Lagja Govori - Abazi";
- "Ndërtimi i rrugës në lagjen Hajdaraj " - fshati Koliq;
- "Ndërtimi i rrugës Svirca " -fshati Nishevc;
- "Ndërtimi i rrugës në fshatin Radashevc";
- "Ndërtimi i rruges Shaban Sijarina -Marevc";
- "Rikonstruimi i rruges "Nekibe Kelmendi";
- " Ndërtimi i urës në fshatin Barilevë dhe zgjerimi i urës në fshatin Prugovc;

- Përgatitja për ofertim i shërbimeve për konsulencë për angazhim të ekspertit për transport rrugorë

Përgatitja për ofertim e revidimit të projektit kryesor me titull "Projekti kryesor, unaza qender Prishtine, pjesa perendimore Lot 2: Rrethrotullimi Lakrishte- Rrethrotullimi Arberi (krahu majtas) Km 0+337.00-1+300.00.L=963.00m per segmentin nga profile P4 deri te profile P29 (e situacionit Lot 2 kM0+337.00-0+620.00(Krahu majtas);

Vërejtje: Revidimi I projektit behet per arsye te shmangjes se nderhyrjes ne trase e hekurudhes se Kosoves dhe varrezave ortodokse.

Ofertimi i puneve shtese; Rr. ne lagjen e Ramabajve- faza II-te"

Rregullimi i nje pjese te ndriçimit te shkollave: "Iliria", " Naim Frasheri", "Emin Duraku, "7 Shtatori", "Hasan Prishtina", "Shkolla e gjelbert", "Gjergj Fishta", "28Nentori", "Andon Zako Çajupi"- Bardhosh, " Shkendija "- Hajvali, Kopshteve: "Ardhmeria", "Dielli".

Renovimi i objekteve: Strehimorja për fëmijët e braktisur të Kosovës, komitetit të grave të verbëra, gëlqerosja e objektit të pensionistëve në Rr."Agim Ramadani", rregullimi oborrit të kopshtit "Zogjet", rregullimi në qendrën sociale në Kodrën e Trimave dhe ndërrimi i dyerve

Lidhjet e marrëveshjeve për pagesën e tarifës rregullative të infrastrukturës.

Shqyrtimi i kërkesave të bashkësive lokale dhe banoreve për ndertimin e rrugëve, mureve mbrojtëse, urave, ujësjellesit, kanalizimeve fekale dhe atmosferike.

Nënshkrimi, planifikimi dhe caktimi i pikave për realizimin e kontratave për mobilitet (asfaltim, shenjzim, ndriçim, trotuare, shkalle, staza për çiklista, pjerrina etj).

Drejtoria e Shëndetësisë



Gjatë kësaj periudhe, është punuar sipas planit të veprimit dhe kemi realizuar disa aktivitete të pa-planifikuara me qëllim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Prishtinës.

Marrëveshja e bashkëpunimit me SHSKUK dhe Komunën e Prishtinës.

- Përmes kësaj marrëveshje Komuna e Prishtinës kursen 200,000 euro në asgjësimin e materialeve mjekësore të Qendrave Mjekësore Familjare.

Ofrimi i kujdesit për pacientët me sëmundje kronike çdo ditë të javës.

- Gjatë muajit mars kemi pasur 796 vizita në raport me 476 pacientë që kanë marrë shërbime në muajin shkurt.
- Prej të hënës deri të premtën punojnë dy ekiye shëndetësore që japin shërbime për qytetarët prej orës 07:00-19:00, ndërsa të shtunën dhe të dielën është një ekip mjekësorë që jep shërbime nga 07:00-19:00.

Nga muaji prill nuk do të ketë listë të pritjes për mamografi.

- Në janar lista e pritjes për mamografi ka qenë 100 qytetarë dhe pritja ka qenë 2 muaj e gjysmë.

Fillon puna e laboratorit biokimik në QMF 4 në Xhemail Ibish

- Gjatë muajit prill fillon puna në laboratorin e QMF 4 i cili për shkak të renovimit nga janari 2021 nuk ka funksionuar puna në laboratorin i biokimisë. Kjo është një nga QMF që ka shumë pacient dhe rikthimi i punës së laboratorit është me shumë rëndësi për qytetarët e kësaj pjese të qytetit.

Në fund të muajit dhjetor janë dorëzuar 2 Autoambulanca QMU-së.

Në kuadër të QKMF janë dorëzuar 3 kombi për shërbimet e dializës.

Vaksinimi ANTI-COVID

- **Janë hapur 4 Qendra të Vaksinimit:**
 - Në QMF Kalabri
 - Sheshi " Zahir Pajaziti "
 - Albi Mall
 - Në QMF " Kodra e Trimave "
- Janë administruar 34, 129 doza të vaksinës Pfizer BioNtech.

TESTIMI PËR COVID 19

- **Janë hapur dy qendra për testim antigjen-test:**
 - Qendra e Studentëve
 - QMF 4 në Xhemail Ibish
- **Janë punuar 19,868 teste Rapide antigjenike**

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

Është kompletuar dokumentacioni që do të shërbejë për shpalljen e konkursit ndërkombëtarë për projektin e Muzeut të Artit Modern, "te Tulltorja", si dhe për projektin e Platformës që do të lidhë Pallatin e Rinisë me lagjen "Arbëria".

Është bërë mbledhja e informacioneve dhe përpunimi i të dhënave për të kompletuar dosjet për projektet si "Parku në Kampusin e Universitetit", "Stacioni i Autobusëve", një pjesë e lagjes "Kalabria", "Zona e Vjetër e Qytetit", "Tregu", dhe "Soliterat" në lagjen "Ulpiana".

Përfundimi i detyrës projektuese për QKPS si dhe përfundimi i paramasës dhe paralogarisë për fushën sportive në lagjen "Sofalia".

Analizë dhe raportim i statusit të procesit të Planit të Zhvillimit Komunal.

Është analizuar plani i punes, procesi i zhvilluar dhe dokumentacioni i realizuar.

Koordinim i vazhdueshëm me Ministrinë e MPPH për statusin e procesit të PZHK. Jemi në pritje të një përgjigje nga MPPH për të vazhduar procesin e shqyrtimit publik të dokumentit.

Shqyrtim i raportimit të ekipit konsulent dhe Grupeve punuese të PZHK mbi procesin 2 vjeçar dhe statusin e draft PZHK. Në takim kompania konsulente e planit dhe Grupet Punuese kanë raportuar mbi;

- Planin Dinamik të Procesit

- Statusin aktual të gjendjes së procesit, fazat në të cilat ka kaluar procesi, vështirësitë që ka hasur ky proces.
- Planifikimi i fazave të mbetura të procesit të realizimit të PZHK dhe HZK

Shqyrtim i raportimit të ekipit konsulent dhe Grupeve punuese mbi përmbajtjen për secilin kapitull të draft PZHK dhe rishikimin e draftit me prioritetet e kryetarit Perparim Rama dhe konceptit të votuar dhe të dalë nga zgjedhjet e Tetorit 2021.

Kompania Konsulente dhe Grupi i Punës kanë raportuar mbi gjetjet e draftit të PZHK duke u ndalur në;

- Bazën e të dhënave GIS të ndërtuar në kuadër të procesit të hartimit të PZHK
- Analizën e gjendjes aktuale të territorit nga pikpamja ekonomike, mjedisore dhe infrastrukturorë e Komunës Prishtinë
- Draft Kornizën Zhvillimore dhe prioritetet strategjike të Komunës Prishtinë

Drejtoria e Sportit



Janë zhvilluar mbi 50 aktivitete sportive në bazë të përkrahjes nga DS, gjatë fazës së dytë të thirrjes publike për subvencionim

Janë mbajtur mbi 20 projekte rinore të cilat janë përkrahur nga DS, gjatë fazës së dytë të thirrjes publike për subvencionim

Janë pranuar dhe kontrolluar mbi 50 raporte financiare dhe narrative të OJQ-ve dhe klubeve sportive, lidhur me subvencionimin e tyre nga Drejtoria për Sport

Është nënshkruar kontrata për ndërtimin e fusheve sportive në Komunën e Prishtinës në vlerë prej 252,688

Është nënshkruar kontrata për rregullimin dhe renovimin e terreneve sportive në Komunën e Prishtinës në vlerë prej 52,847

Janë realizuar punët shtesë dhe përmirësimi i punëve të kontratës ndërtimi i infrastrukturës së shtigjeve për ecje dhe vrapim në "Arbëri", në vlerë prej 10,966

Janë regjistruar 5 klube të reja sportive

Është organizuar event "Laureatët e vitit 2021".

Kanë filluar punimet në tribunën lindore të Stadiumit të "2 Korrikut"

Është caktuar lokacioni për ndërtimin e një fushe të futbollit në Hajvali

Drejtoria e Inspektionit

Është rritur numri i zonave inspektuese nga katër në shtatë, rrjedhimisht, janë rritur dhe ndryshuar edhe ekipet inspektuese, nga katër në shtatë.

Janë identifikuar gjithsejtë 41 kërkesa për inspektime finale të cilat kanë pritur me vite (2017-2022), ndërsa prej tyre janë vetëm tetë të pranuaruara këtë vit.

Sektori i Ndërtimit gjatë përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi si më sipër ka nxjerrë: 7 Aktvendime për rrënim, prej tyre 4 të ekzekutuara katër; 29 Aktvendime për ndërprerje të punëve Gjyba mandatore të shqiptuara, njëzet e shtatë, në vlerë prej 13.200 EUR;

245 Ankesa dhe kërkesa të ndryshme të qytetarëve të pranuaruara (dhjetor, janar, shkurt)

Ankesa; dhe kërkesa të shqyrtuara, duke përfshirë edhe ato të vitit 2021, gjithsejtë 397.

Përmes Sektorit të Rendit Komunal, kemi ndërmarrë aksion për lirimin e trotuareve dhe hapësirave publike në përgjithësi në gjithë qytetin e Prishtinës.

Është bërë lirimi i shesheve (Sh. Ibrahim Rugova, Sh. Skenderbeu, Sh. Nënë Tereza, Sh. Zahir Pajazitit) duke larguar të gjithë shitësit ambulantë dhe lypsarët dhe me qëllim të mbajtjes së këtyre shesheve të pastra dhe të lira për shfrytëzim nga qytetarët e Prishtinës dhe vizitorët.

Kemi liruar hapësirat publike, të cilat kanë qenë të uzurpuar tash e gati tetë (8) vite me lodra (jofunksionale), rrëzimin e disa objekteve me karakter të përkohshëm si dhe largimin e disa kontejnerëve dhe mbeturinave të shumta e të grumbulluara në dy hapësira publike: 1. Hyrja qendrore e parkut të Tauk Bashqes dhe 2. Hapësira afër hyrjes së QKUK-së.

Përveç kontrollit të vazhdueshëm që kemi bërë

ndaj taksive ilegal, kemi ndërmarrë aksion kontrolli edhe ndaj kompanive të regjistruara të cilat organizojnë bartjen e udhëtarëve brenda Komunës së Prishtinës.

Janë mbyllur deponitë e mbeturinave inerte (kryesisht material ndërtimor) në zona të ndryshme të Prishtinës (Mati 1 dhe Zllatar – pjesa e Badovcit dhe Hajvalisë), për shkak të skadimit të pëlqimeve që kishin kompanit të caktuara të ndërtimit

Drejtoria e Bujqësisë

Subvencione në Bujqësi

- Komuna e Prishtinës është duke përkrahur sektorin e blegtorisë me subvencionim në vlerë prej 150,000.00 EUR, e gjedheve qumështore, deleve dhe dhive në formë të pagesave direkte ku përfitues do të jenë rreth 300 fermer.
- Gjithashtu do të përfitojnë edhe 280 bletarë, të cilët do të përkrahen në formë të pagesave direkte. Ky subvencionim do ta këtë vlerën në total 50,000.00 EUR në mënyrë që të vazhdohet aktiviteti i tyre.

Kjo formë e përkrahjes bëhet me qëllim që këta sektor të rëndësishëm të mund të mbajnë një kontinuitet dhe të rrisin kapacitetet e tyre prodhuese.

Furnizimi dhe montimi i serrave

- Në projektin e serrave gjithsej do të përfitojnë 20 fermerë, vlera totale e kësaj mbështetje është 168,436.80 EUR.
- Procesi i aplikimit ka përfunduar Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve është duke finalizuar projektin.

Tregu Mobil

- Gjithsej 50 fermerë do të përfitojnë dhe do të kenë mundësi të ekspozimit të produkteve të tyre në tregun Mobil.
- Të gjitha procedurat kanë përfunduar (renovimi i shtandeve të tregut mobil, përzgjedhja e përfituesve)

Projekti "SIREĐ"

- Bashkëfinansim mes Komunës së Prishtinës dhe Agjencinës Austriake për Zhvillim (ADA), implementues CARITAS. Komuna e Prishtinës gjatë kësaj periudhe ka alokuar mjete në vlerë prej 500.000 EUR.
- Përfitues nga ky projekt janë agrobizneset në Komunën e Prishtinës me fokus të veçantë kultivuesit e bimëve aromatike mjekësore (BMA), përpunuesit e perimeve, kultivuesit e pemëve të imëta.
- Në kuadër të këtij projekti një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe përkrahjes së gruas në bujqësi.

Furnizimi me pajisje bletare

- Jemi në fazën e mbështetjes për bletarët me centrifuga elektrike për nxjerrjen e mjaltit, depozitorë të mjaltit me kapacitet 50 kg, si dhe bluza për bletarë.

Furnizimi me motokultivatorë dhe makina mjelëse

- Jemi në fazën e mbështetjes për aplikim për kultivatorët dhe makinat mjelëse të cilat gjenden.

Përkrahja e fermerëve për kultivimin e bimëve aromatike-mjekësorë (BMA)

- Jemi në fazën e përgatitjes së thirrjes për

mbështetjen e fermerëve për kultivimin e bimëve mjekësorë-aromatike (BMA), ku do të mbështetën 30 deri 50 fermerë me vlerë të subvencionit 10,000.00 EUR.

Përkrahja e fermerëve për ujitjen e tokave bujqësore

- Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me kompaninë Regionale "Iber Lepenci", do të përkrah ujitjen e 200 Ha, tokë bujqësore me kultura të ndryshme.

Vlera e projekteve në realizim e sipër është- 402,436.80 EUR

Projekti SIREĐ- 500,000.00 EUR

TOTALI: 902,436.80 EUR

Drejtoria e Arsimit



Objektivat e parashtruara nga Drejtoria Komuna e Arsimit në periudhën raportuese janë realizuar përmes aktiviteteve të ndryshme, duke respektuar legjislacionin në fuqi, si vijon:

Janë zhvilluar mbi gjashtëdhjetë (60) vizita në terren të institucioneve edukative-arsimore, me qëllim të mbikëqyrjes së vazhdueshme të procesit edukativo arsimor;

Janë zhvilluar mbi pesëmbëdhjetë (15) vizita speciale në institucionet edukative arsimore për

çështje të ndryshme arsimore;

Procesimi i të dhënave për testin PISA 2022, duke harmonizuar evidentimin e të dhënave përkatëse;

Procesimi i të dhënave për Vlerësimin Ndërkombëtar TIMSS 2023, me qëllim të parashtrimit të objektivave vlerësuese;

Është draftuar analizën e përgjithshme në të gjitha shkollat lidhur me kërkesat dhe nevojat për mbajtjen e trajnimeve të stafit për gjithëpërfshirje;

Organizimi i Trajnimit për të Drejtat e Fëmijëve me 30 mësimdhënës të përzgjedhur nga institucionet edukative-arsimore, me qëllim të vetëdijesimit me të drejtat e fëmijëve;

Në bashkëpunim me Olimpiadën e Matematikës kanë organizuar me sukses garat në nivel komunal për lëndën e matematikës për nxënësit e klasëve IX, X, XI, dhe XII;

Është organizuar me sukses garën në nivel komunal "Garën e Fizikantëve të Rinj" për lëndën e fizikës, për nxënësit e klasëve IX, X, XI dhe XII;

Në bashkëpunim me Caritasin zviceran ka organizuar trajnimin e edukatorëve "Përgatitja e edukatorëve para fillore për përkrahjen dhe zhvillimin e potencialit të fëmijëve përmes lojës dhe kreativitetit".

Në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimi ka organizuar trajnimin për 70 edukatore në nivelin para fillor, të përkrahur edhe nga UNICEF;

Është organizuar vlerësimi i dosjeve të trajnimit për Kurrikulë për 150 mësimdhënës në shtatë fusha kurrikulare, si: Gjuhë dhe Komunikim; Matematikë; Shkenca natyrore; Shoqëria dhe Mjedis; Jeta dhe Puna për mësuesit klasorë dhe klasët përgatitore;

Në bashkëpunim me MASHT ka organizuar klasën dimërore të skijimit, ku në bazë të kriterëve të përcaktuara është zgjedhur shkolla me suksesin më të mirë në nivel komunal;

Është identifikuar dhe organizuar mësimin

plotësues për të gjithë nxënësit e riadhesuar;

Janë angazhuar psikologët shkollor në ligjërata këshilluese në një institucion edukativo-arsimor;

Janë përzgjedhur mësimdhënësit më të mirë në secilin nivel të arsimit para universitar për nder të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit;

Është organizuar ceremonia e Ditës së Mësuesit, me ç'rast janë ndarë mirënjohjet për mësimdhënësit më të mirë në arsimin para universitar në Komunën e Prishtinës;

Është organizuar ceremonia e ndarjes së mirënjohjeve për nxënësit fitues në garat komunale të organizuara në lëndën e matematikës dhe fizikës;

Në bashkëpunim me Këshillin e Pavarur të Mediëve ka organizuar trajnimin dy-ditor për edukim medial të nxënësve të dy institucioneve edukative arsimore të Komunës të Prishtinës;

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ka organizuar ligjërata në gjashtë institucione edukative arsimore për dhunën në shkolla;

Në bashkëpunim me Qendrën Kulturore e Fëmijëve të Komunës të Prishtinës ka organizuar audicionin e aktiviteteve në drejtimet, si vijon: Kor, Valle, Sport (ping-pong), Asamble folklorike dhe Klubin e Ambasadorëve të Rinj;

Organizimi i takimit me përfaqësuesit e BE-së, MASHT dhe kompaninë për implementimin e projekteve të IPA 2018. Komuna e Prishtinës në këtë projekt është përfituese për renovimin e dy shkollave: SHML "Sami Frashëri" dhe SHFMU "Dardania";

Takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e KfW dhe Agjencionit për Eficiencë të Energjisë në lidhje me renovimin e tërësishëm e dy shkollave fillore të Prishtinës;

Takime me përfaqësuesit e LUX-dev dhe MASHT, për implementimin e projektit për renovim të ish-Shkollës Ekonomike, tani qendër e kompetencës. Në këtë takim është diskutuar rreth dizajnit të projektit, koha kur priten të fillojnë punimet, organizimi i procesit mësimor

gjatë punimeve dhe plani dinamik i punimeve.

Furnizimi me pajisje të kabineteve për nxënësit e shkollave profesionale për punë praktike në SHML “Prenk Jakova” dhe SHML “28 Nëntori”;

Është inicuar procedura për shpallje të aktiviteteve si: Furnizimi me rekuizita sportive, furnizim me vegla pune dhe furnizim me material didaktik, për artikuj që nuk janë me AQP;

Është organizuar takim me nxënësit përdorues të karrocave më datën 1 Mars, duke zhvilluar disa aktivitete përkatëse dhe dhuratë simbolike.

Koordinim me përfaqësues të “Manifestës” për organizimin e MANIFESTA 2022 në kuadër të Komunës së Prishtinës;

Kemi ndihmuar në organizimin e Panairit të Edukimit, me ç’rast nxënësit e shkollave të mesme kanë patur mundësinë për informimin e mundësive të ndryshme studimore në shkolla dhe universitete vendore e ndërkombëtare.

Kemi procesuar formularin Sofrecom në të gjitha institucionet edukative-arsimore dhe aftësuese për të evidentuar kyçjen e të gjitha shkollave në internet. Ideja është që gradualisht të procesohet projekt i veçantë që secila klasë në kuadër të IEAA-ve të ketë internet;

Është iniciuar bashkëpunimin e vazhdueshëm me bizneset për përcaktimin dhe përzgjedhjen e nxënësve për punë praktike

Ekipi vlerësues pedagogjik komunal ka zhvilluar takime dhe janë vlerësuar gjithsej dymbëdhjetë raste. Takimet e ekipit vlerësues pedagogjik komunal zhvillohen për shqyrtimin e rasteve përkatëse.

Në bashkëpunim me kompaninë kontraktuese është bërë shpërndarja e testeve në institucionet shkollore. Gjatë pranimit të produktit, kompania e kontraktuar ka parashtruar informatat e hollësishme dhe trajnimin rreth përdorimit të testeve antigjen.

Është publikuar lista përfituesve të bursave të Komunës të Prishtinës, për 113 studentë të Prishtinës

Jemi në proces të vlerësimit të nevojave për kërkesat e ndryshme infrastrukturore të IEAA-ve;

Mbikëqyrja e procesit edukativ lidhur me raste të ndryshme të paraqitura në IEAA-të.

Drejtoria e parqeve



Drejtoria e Parqeve është angazhuar në identifikimin e hapësirave publike për zhvillimin e parqeve të reja në qytetin e Prishtinës. Janë identifikuar disa lokacione me interes të veçantë për qytetarët e Prishtinës, si:

- Hapësira në lagjen “Kodra e Trimave”, te pompat e ujit,
- Në “Bregun e Diellit”, te banesat e bardha,
- Në rrugën “Enver Maloku”,
- Në “Dragodan” dhe te shkallët e Dragodanit,
- Në lagjen “Ulpiana”, dhe
- Në lagjen Kalabria.

Po vijon procesi i evidentimit edhe të zonave të tjera të cilat mund të shfrytëzohen si hapësira të

gjelbra, atyre zonave të degraduara për revitalizimin e tyre si dhe për rregullimin e parqeve në cdo lagje të qytetit.

Është bërë mirëmbajtja e hapësirave publike dhe krasitja e drunjve në lagjet dhe sheshet e qytetit.

Drejtoria e Kulturës



Janë përgatitur dhe publikuar, në sistemin online, 2 thirrjet e fazës së I-rë për subvencionet në fushën e kulturës.

Ka vazhduar koordinimi në mes të Komunës së Prishtinës dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) për restaurimin e "Sahat Kullës", bazuar në marrëveshjen e bashkëfinancimit të nënshkruar në 2021. Punimet e restaurimit kanë filluar nga 31 marsi.

Është nisur për shqyrtim në IKMM projekti i reviduar "Rruga Model"- projekti i rigjenerimit të rrugës "Mehmet Kaqurri". Ky projekt është iniciuar në vitin 2020. Punimet kanë mbetur të papërfunduara sepse operatori ekonomik ka qenë i papërgjegjshëm dhe si rezultat është shkëputur kontrata. Paramasa e reviduar është përgatitur nga CHwB. Pas shqyrtimit në IKMM do të vazhdojmë tutje me procedura të rradhës.

Në kuadër të "Manifestës", janë realizuar takime me Ambasadën Amerikane, Gjermane, Suedeze, të Luksemburgut, atë Japoneze dhe

Franceze, për ngritje të fondeve për projektet: "Green Corridor", "Missing Bridge", "Tulltorja" dhe biblioteka "Hivzi Sulejmani".

Janë organizuar aktivitete të ndryshme me rastin e shënimit të 17 shkurtit, Ditën e Pavarësisë.

Jemi në fazën e ri funksionalizimit të Zyrës Informativ Turistike.

Drejtoria e shërbimeve publike, mbrojtjes dhe shpëtimit

Në kuadër të fushëveprimit, mundësive, kapaciteteve teknike dhe buxhetore kemi vazhduar me realizimin e projekteve dhe objektivave si në vijim:

Menaxhimin e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve në qytet dhe fshatra, trotuareve, hapësirave publike, pllatove dhe nënkalimeve

Menaxhimin e mbeturinave dhe ofrimin e shërbimit primar për grumbullimin e mbeturinave. Përmes kësaj kontrate menaxhohet me mbeturinat nga amvisëritë, mbeturinat e vëllimshme si dhe largimi i deponive ilegale në territor të komunës

Monitorimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik

Monitorimin dhe mirëmbajtjen e semaforëve

Rregullimin dhe riparimin e ashensorëve. Me bashkëfinancim me banorët janë rregulluar 6 ashensor në lagje të ndryshme të qytetit

Intervenimet emergjente në të gjithë qytetin.

Bashkëpunimi me Bankën Botërore për përgatitjen e projektit për:

- Hartimin e projektit për organizimin e transportit në "M9 CORRIDOR";
- Bashkëpunimi në hartimin dhe implementimin e projekteve për një "LIVABLE PRISHTINA";
- Bashkëpunimi në hartimin dhe implementimin e projekteve për një "SMART MOBILITY";

Bashkëpunim me GIZ dhe KRM Pastrimi - Analiza e sasisë së mbeturinave, analiza e lokacioneve të kontejnerëve ekzistues, analiza e lokacioneve optimale të kontejnerëve dhe numrit të tyre si dhe hartimi i projektit për rregullimi i lokacioneve të kontejnerëve në lagjen Mat 1.

Zhvillimi i projektit për ndërtimin e Qendrës për Grumbullimin dhe Trajtimin e Mbeturinave Ndërtimore.

Zhvillimi i projektit për Qendrën për Rishfrytëzim të mbeturinave. Kjo qendër do ta bëjë Komunën e Prishtinës ndër të parat e cila do të bën hapa drejt konceptit 3R (Recycle, Reuse & Reduce).

Përmbyllja e projektit për Qendrën e Kompostimit. Komuna e Prishtinës përmes DSHPMSH-së është në fazën përmbyllëse të projektit për ndërtimin e Qendrës për Kompostim. Kjo qendër do të ndërtohet në bashkëpunim me GIZ dhe CMSR dhe parashihet të funksionalizohet gjatë muajit maj.

Intervenimet emergjente në këtë periudhë ishin të pashmangshme, ndërsa ato më kryesoret ishin:

- Debllokimi i rrugës "Siqevë-Sharban" dhe rrugën "Abduh Rrahim Nokshiq" nga shembja e dheut dhe gurëve
- Evitimi i rrezikut në rrugën "Xhemajl Prishtina" duke shembur një pjesë të shtëpisë së vjetër
- Evitimi i rrezikut në rrugën Luan Haredinaj

duke larguar disa elemente përforcuese nga kulmi i një objekti të vjetër

- Debllokimi i rrugëve nga rrezimi i drunjve si pasojë e erërave të forta;

Formimi i grupit punues për hartimin e planeve operative emergjente. Ky grup parashihet të punoj:

- Planin Operativ Emergjent
- Plani Kundër Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive tjera
- Plani i Mbrojtjes nga Zjarrit

Drejtoria e Pronës

Hartimi dhe publikimi i listës së përgjithshme të pronës komunale (Komuna e Prishtinës nuk ka përditësuar listën e pronës komunale nga viti 2015 ndërsa, pavarësisht se nga viti 2019, kjo gjë është kërkuar me Ligj, publikimi nuk është bërë asnjëherë).

Hartimi i Listës së Veçantë për pronat komunale të cilat planifikohet të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2022, ku ndër të tjera përfshihen pronat në të cilat do të zhvillohen projekte të mëdha të premtuara siç janë: Strehimorja për kafshët, Parku për festivale, Thertorja e qytetit, fusha të futbollit si dhe Kuarti për Ambasada.

Përditësimi i hartës me të dhënat e reja për pronën komunale në bazë të listës së përgjithshme të pronës komunale.

Formimi i grupit punues për verifikimin e statusit të pronës komunale i cili do të bëjë identifikimin e pronës së paluajtshme në bazë të Listës së Përgjithshme të Pronave dhe verifikimin e statusit të tyre duke nisur nga Qendra e Prishtinës.

Formimi i grupit punues për unifikimin e emërtimeve për pronën komunale në regjistrat kadastralë në pajtim me Ligjin për Kryeqytetin. Në përfundim të këtij procesi, të gjitha pronat e paluajtshme të Komunës së Prishtinës do të mbanjnë emërtimin unik "Pronë e Kryeqytetit".

Vendimi për lirimin e pronës komunale pranë QKUK-së dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij vendimi nga Drejtoria e Inspeksionit.

Vendimi për lirimin e pronës komunale tek Parku i Taukbashqes dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij vendimi nga Drejtoria e Inspeksionit.

Drejtoria e Kadastrit



Është implementuar **86.0 përqind (%)** i planit të drejtorisë duke i aprovuar, refuzuar dhe pezulluar kërkesat e palëve në procedurë sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

Janë pranuar gjithsej **9,239** kërkesa, nga të cilat janë aprovuar/miratuar **7,965** kërkesa, refuzuar **41** kërkesa dhe kanë mbetur në procedurë edhe **1,189** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes 2 sektorëve: sektorit të kadastrit dhe sektorit të gjeodezisë.

E arritur e kësaj Drejtorie në aspektin procedural është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve ka arritur të nxjerr vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët

/subjektet juridike, për ato që janë përfunduar.

Sektori i kadastrit aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër janë:

- Lëndët në shpallje publike në afat ligjor prej 5 ditë punë që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral.
- Lëndët e dërguara në KPA verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave.
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, arkivi komunal ose ndërkomunal.

Sektori i gjeodezisë aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër janë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave.
- Lëndët për identifikimin e njësive banesorë.
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

Pas rikthimit të normalitetit me gjendjen pandemike në vend, janë caktuar sërish ditët e takimeve me palë, Sektori i Gjeodezisë (ditën e mërkure nga ora 10:00-12:00), kurse Sektori i Kadastrit (ditën e enjte nga ora 10:00-12:00).

Është iniciuar çështja e digjitalizimit të nxjerrjes së Certifikatës së Pronës në koordinim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Finalizimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Komunës së Prishtinës mbi sistemin e adresave.

Është iniciuar përgatitja e këndit të informimit për qytetarët, që shërben për qartësim të hapave procedural dhe dokumenteve që nevojiten për kryerje të shërbimeve komunale që ofron drejtoria

Drejtoria e Mirëqenies Sociale

Gjatë kësaj periudhës:

- Janë pranuar 945 kërkesa për subvencionim të kategorive të ndryshme sociale
- Ka filluar shqyrëtimi i këtyre kërkesave nga komisioni përkatës
- Janë ndarë 800 mijë euro për subvencione (disa veçse kanë filluar të ekzekutohen)
- Kemi shqyrtuar gjithësejtë 189 lëndë

- 156 Kërkesa të Miratuar
- 33 Lëndë në Plotësim dokumentacioni;
- 156 Vendime

Në Qendrat për Punë Sociale ka vazhduar puna e përditshme, me lëndë të ndryshme nëpër gjykata, me vendime të ndryshme administrative.

Po ashtu puna në Qendrat e të moshuarve ka vazhduar sipas rrjedhës së saj të zakonshme, duke mos u paraqitur ndonjë problem.





PRISHTINA
